

VENDIM
Nr. 25, datë 14.2.2022

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “HEC TERFOJA” SHPK, NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; i ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa “e”, nenit 5, pika 1, germa “e”, nenit 10, pika 3, të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe nenit 19, pika 1, germa “a”, të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 14.2.2022, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 204/3 prot., datë 2.2.2022, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “HEC Terfoja” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “HEC Terfoja” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 175 prot., datë 24.1.2022 ka paraqitur aplikimin për t’u pajisur me licencë në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Shoqëria “HEC Terfoja” sh.p.k., ka kryer pagesën e aplikimit në zbatim të aneksit A, të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

- Nga shqyrtimi i dokumentacionit në fazën e fillimit të procedurave të licencimit në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për shoqërinë “HEC Terfoja” sh.p.k., rezulton se subjekti plotëson kryesisht kërkesat e rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, si më poshtë:

- Format i dhe dokumentacioni për aplikim. Neni 9, pika 1, gjerat “a”, “b” dhe “c”. Plotësuar.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor. Neni 9, pika 2, gjerat “a”, “b”, “c”. Plotësuar.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal. Neni 9, pika 3, gjerat “a”, “b”, “d”. Plotësuar.

- Në lidhje me mungesën e dokumentacionit, që ka të bëjë me:

Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor. Neni 9, pika 2:

- germa “d” (vërtetimi nga Prokuroria dhe Gjykata për përfshirje ose jo në një proces penal të drejtuesve të shoqërisë). Plotësuar pjesërisht. Shoqëria duhet të depozitojë në ERE vërtetimet e gjykatës dhe të prokurorisë me data të përditësuara.

- germa “e” (struktura e ndërtimit dhe funksionimit administrativ të shoqërisë, sipas pozicioneve dhe profileve përkatëse). Plotësuar pjesërisht. Shoqëria duhet të përcjellë në ERE strukturën e organizmit të saj ku të përfshihet edhe stafi përkatës për veprimtarinë e tregtimit të energjisë.

Dokumentacioni financiar dhe fiskal. Neni 9, pika 3:

- germa “c” (dokumente që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit, ku shprehen qartë vlerat monetare për financimin dhe strukturën e financimit (financim i vetë aplikuesit, kredi bankare, donacion të tjera), pa plotësuar. Shoqëria duhet të depozitojë në ERE sa kërkon kjo pikë e rregullores.

Dokumentacioni teknik për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike. Neni 9, pika 4.8:

- germa “a” (sasia e energjisë elektrike e parashikuar për t’u tregtuar në GWh/sipas viteve); pa plotësuar. Shoqëria duhet të paraqesë sasi të energjisë të parashikuara për t’u tregtuar në GWh për pesë vitet e licencës;

- germa “b” (kapitali financiar i parashikuar për ushtrimin e këtij aktiviteti); pa plotësuar. Shoqëria duhet të paraqesë në ERE dokumentacionin përkatës, do të njoftohet subjekti që në bazë të neneve 10, pikat 10 dhe 11, të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, t’i paraqesë ato brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “HEC Terfoja” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti